

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË**

**Zgjidhjet**

**P4**

Nr.

**FLETË PROVIMI**

**Udhëzime :**

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Data 09.07.2016

## Pjesa A. Pyetjet “rumbullakos përgjigjet”

Nga 1 pikë secila

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare mund të krijohen vetëm pas përfundimit të procedurës së regjistrimit në Zyrën e Regjistrimit sipas kushteve të parapara më ligjin “Për Shoqëritë Tregtare” .

**E saktë**

E pasaktë

2. Sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, emri që është paraqitur për regjistrim për një shoqëri tregtare duhet të dallojë në masë të arsyeshme nga të gjithë emrat paraprakisht të regjistruar nga shoqëritë tjera tregtare:

**E saktë**

E pasaktë

3. Një person ose shoqëri tregtare e cila ka për qëllim ta shfrytëzojë një emër tregtar brenda një afati vijues prej njëqindnjëzet (120) ditësh mundet, në qoftë se ky emër tregtar nuk është rezervuar ose regjistruar më parë, ta rezervojë shfrytëzimin ekskluziv të këtij emri tregtar, duke ia paraqitur regjistrimit një kërkesë mbi rezervimin e emrit tregtar. Kërkesa duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtruesit të kërkesës dhe emrin tregtar të cilin dëshiron ta rezervojë.

E saktë

**E pasaktë**

4. Një ortakëri e përgjithshëm ekziston sa here që të kemi minimum një ortak të përgjithshëm.

E saktë

**E pasaktë**

5. Personi i cili është pronar i një ndërmarrje individuale, qoftë të regjistruar apo të pa regjistruar, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një ndërmarrje individuale.

**E saktë**

E pasaktë

6. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Pasqyrat financiare të shoqëritë tregtare të mesme do të auditohen nga firmat e auditimit që janë të licencuar për të kryer auditime nga autoritetet kompetente siç janë definuar në këtë ligj.

E saktë

**E pasaktë**

7. Shoqëritë tregtare, subjekte të këtij ligji, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

**E saktë**

E pasaktë

8. Këshilli i Kosovës Për Raportim Financiar (KKRF) përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë.

E saktë

**E pasaktë**

9. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Shoqëritë tregtare mëdha dhe të mesme sipas të këtij ligji, mund të mbajnë regjistrat kontabël edhe në Gjuhën angleze, pa qenë të detyruara që pasqyrat financiare, të përkthejnë në gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës.

E saktë

**E pasaktë**

10. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Shoqëritë tregtare janë të obliguara të ruajnë pasqyrat financiare bashkë me librat ndihmëse në afat prej dhjetë (10) vitesh.

**E saktë**

E pasaktë

11. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe ne udhëzimet përkatëse administrative, pavarësisht nga kërkesat për mbajtjen e regjistrave të parashikuara në legjislacionet dhe udhëzimet e tjera administrative tatimore: një person i cili ka detyrë të krijojë regjistra sipas këtij ligji do t'i mbajë ato regjistra për një periudhë prej së paku gjashtë vjet pas përfundimit të periudhës tatimore kur ka lindur një detyrim i tillë tatimor përkatës;

**E saktë**

E pasaktë

12. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kushdo që kryen veprë penale në fushën e tatimeve apo merr pjesë në atë mënyrë të bashkëkryerjes, shtytjes apo ndihmës do të jenë bashkërisht dhe individualisht i detyruar për ikje të tatimeve.

**E saktë**

E pasaktë

13. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo person që ka detyrë t'i paguajë tatime ATK-së sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë, do të paguajë tatimin e tillë në kohën dhe vendin e specifikuar në legjislacionin e tillë ose rregullat e zbatimit, vetem pas njoftim ose kërkesë nga ana e ATK-së.

E saktë

**E pasaktë**

14. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, interesi gjithashtu mund të llogaritet për ato shuma të ndëshkimit që bazohen në shumën e tatimit bazë. Ky interes nuk bën të fillojë te përlllogaritet së paku deri në njëqindnjëzet (120) ditë pasi që tatimi në të cilin aplikohen ndëshkimet është vlerësuar dhe se tatimpaguesi është njoftuar se interesi do të fillojë të rrjedh mbi ndëshkimet në qoftë se bilanci tatimor mbetet i papaguar.

**E saktë**

E pasaktë

15. -Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nëse një person i cili është i detyruar t'i paguajë ndonjë tatim ndaj ATK-së sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë shpërfill apo refuzon të paguajë atë tatim brenda dhjetë (10) ditëve pas dorëzimit të njoftim-vlerësimit, do të lind një barrë në atë pasuri, apo të drejtat për pasurinë që i përket atij personi (qoftë e luajtshme apo e paluajtshme, e trupëzuar apo e patrupëzuar) në një shumë të barabartë me tatimin e papaguar, plus interesin, pagesën, ndëshkimet dhe shpenzimet e mbledhjes.

**E saktë**

E pasaktë

16. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori janë të ardhura te përjashtuara nga tatimi.

**E saktë**

E pasaktë

17. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet e reklamës dhe promocionit të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billbordat, reklamat transite e të tjera të ngjashme, janë shpenzime tërësisht të zbritshëm për qëllime tatimore

**E saktë**

E pasaktë

18. Sipas ligjit nr.05/L-028 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, nëse një tatimpagues blen linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anijet, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllimet e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit, lejohet një zbritje e veçantë prej njëzet për qind (20%) të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim

E saktë

**E pasaktë**

19. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, kontributet pensionale mbi shumën maksimale të lejuar nga legjislacioni përkatës mbi pensionet në Kosovë janë shpenzime te pa lejueshme.

**E saktë**

E pasaktë

20. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, në rastet kur afati i përdorimit i një pasuri të paprekshme nuk është i përcaktuar, shpenzimet e amortizimit lejohen deri në pesëdhjete (50) vite.

E saktë

**E pasaktë**

21. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej tre përqind (3%) të bruto pagesës, në momentin e pagesës.

**E saktë**

E pasaktë

22. Sipas ligjit te TVSh-se, nëse personi brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30.000€) kërkohet që të regjistrohet për TVSH.

**E saktë**

E pasaktë

23. Sipas Ligjit të TVSH-se, momenti i lindjes së detyrimit ndodhë dhe TVSH-ja bëhet e ngarkueshme kur bëhet furnizimi i mallrave dhe shërbimeve. Përjashtim bëjnë kontratat afatgjate, përfshirë këtu kontratat ndërtimore afatgjate dhe kontratat afatgjate të instalimit, duhet të konsiderohen si të përfunduara:
1. në muajin e lëshimit të situacionit, por jo më larg se një muaj pas lëshimit të situacionit në rastet kur pranimi teknik i punëve bëhet më vonë;
  2. në rastet kur gjatë vitit janë lëshuar një apo më shumë situacione, në fund të vitit kërkohet që të lëshohet një situacion i cili do të bazohet në matjen reale të punëve të kryera; ose,
  3. nëse gjatë vitit nuk lëshohet asnjë situacion, atëherë në fund të vitit do të lindë detyrimi për të ngarkuar TVSH bazuar në matjen reale të punëve të kryera.

**E saktë**

E pasaktë

24. Vendi i furnizimit të shërbimeve për personin e tatueshëm sipas ligjit të TVSH-se për transport të pasagjerëve është vendi i arritjes së transportit;

E saktë

**E pasaktë**

25. Sipas ligjit të TVSh-së, vendi i furnizimit të shërbimeve për personin jo të tatueshëm, do të jetë vendi ku furnizuesi e ka themeluar biznesin e tij.

**E saktë**

E pasaktë

26. Sipas ligjit të TVSh-se, furnizimet me ujë, përveç ujit të ambalazhuar aplikohet norma e reduktuar (8%).

**E saktë**

E pasaktë

27. Furnizimi i shërbimeve nga mediat elektronike të radios dhe televizionit është furnizim i liruar me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshëm

E saktë

**E pasaktë**

28. Periudhat që lejohet paraqitja e një kërkesë për rimbursimin e TVSH-se nëse janë plotësuar kriteret e rimbursimit është për çdo tre muaj.

**E saktë**

E pasaktë

29. Sipas ligjit të TVSH-se, transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit të jetës dhe shëndetit, duke përfshirë shërbimet e lidhura të bëra nga brokerat e sigurimit dhe agjentët e sigurimit, janë furnizim i liruar pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshëm.

**E saktë**

E pasaktë

30. Personi i tatueshëm nuk mund të zbres TVSH-në e zbritshëm para periudhës tatimore në të cilën ai i ka pranuar faturat për mallrat apo shërbimet e furnizuara për të ose në të cilën ai ka pranuar deklaratën e doganës për mallrat e importuara.

**E saktë**

E pasaktë

31. Sipas ligjit të TVSH-së vlera totale e blerjes dhe shpenzimet rrjedhëse lidhur me veturat e shfrytëzuara edhe për qëllime personale, njëkohësisht edhe për qëllime biznesi e drejta për të zbritur TVSH-në e zbritshëm lejohet deri në pesëdhjetë për qind (50%).

**E saktë**

E pasaktë

32. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, mosha e pensionimit është mosha gjashtëdhjetë e pesëvjeçare (65).

**E saktë**

E pasaktë



33. Sipas Ligjit mbi Pensionet ne Kosove, Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve pensionale në Kosovë.

**E saktë**

E pasaktë

34. Punëdhënësit mund të kontribuojnë vullnetarisht për një shumë plotësuese deri në pesë përqind (5%) të rrogës vjetore, për një shumë të përgjithshme prej dhjetë përqind (10%) të rrogës.

E saktë

**E pasaktë**

35. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, në rastet kur rrogat për orar të plotë, qoftë të paguara në natyrë ose ndryshe, janë më të vogla se Paga Minimale, punëdhënësi i paguan pesë përqind (5%) të rrogës minimale dhe punonjësi paguan pesë përqind (5%) të rrogës se tij ose të saj për orar të plotë pune.

**E saktë**

E pasaktë

36. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, pagesa e kontributeve është e detyrueshme për të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe të punësuarit e huaj deri në moshën e pensionimit.

E saktë

**E pasaktë**

37. Sipas Ligjit te Punës, nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

**E saktë**

E pasaktë

38. Sipas ligjit të Punës, puna e detyruar ose e dhunshme është e ndaluar pa përjashtim duke u përfshire puna ose shërbimi të cilin e kryejnë personat e dënuar me aktgjykim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit apo edhe raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

E saktë

**E pasaktë**

39. Sipas Ligji të Punës, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindënjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

**E saktë**

E pasaktë

40. Sipas Ligjit të Punës, orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, mund të jetë maksimum katërdhjetë (40) orë në javë.

E saktë

**E pasaktë**

## Pjesa B. Pyetjet problemore

### Problemi 1

10 pikë

Lemon Sh.p.k. regjistroj blerje gjatë 2015 në shumën Eur 220,000. Shitjet vendore ishin Eur 650,000 dhe eksportet ishin Eur 10,000. Shitjet e përjashtuara pa të drejt kreditimi Eur 350 000 (Në vlerat e paraqitura nuk është përfshirë TVSH-ja).

Gjatë muajit Maj 2016 Lemon Sh.P.K regjistroj blerje në shumën Eur 20,000 (për të gjitha blerjet është paguar TVSH me normën standarde); shitje vendore Eur 35,000 (me normën standarde të TVSH); shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi Eur 12,000. (Në vlerat e paraqitura nuk është përfshirë TVSH-ja).

#### Kërkohe:

- Sa është koeficienti i TVSH-së së zbritshëm për vitin 2015?
- Sa ka detyrim të TVSH-së për të paguar në muajin Maj 2016 Lemon Sh.P.K?

Zgjidhja,

#### Zgjidhje

$$a) PZ = \frac{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{eksporte}}{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{eksporti} + \text{Furnizimet e përjashtuara}} \times 100$$

$$PZ = \frac{650,000 + 10,000}{650,000 + 10,000 + 350,000} \times 100 = 65\%$$

b)

Libri i shitjeve

Shitje te përjashtuar pa te drejt kreditimi	12,000
Shitjet vendore	$35,000 \times 18\% = 6,300$
TOTAL TVSH e llogaritur	6,300

Libri i blerjeve

Blerjet pa te drejt kreditimi <sup>(1)</sup>	8,260
Blerjet $(20,000 \times 65\%)^{(2)}$	$13,000 \times 18\% = 2,340$
TOTAL TVSH e zbritshëm	2,340

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshëm

$$\begin{aligned} \text{TVSH e pagueshme} &= 6,300 - 2,340 \\ &= 3,960 \end{aligned}$$

(1)  $20,000 \times 35\% = 7,000 \times 18\% = 1,260$  TVSH qe nuk pranohet e zbritshëm  
 $7,000 + 1,260 = 8,260$

(2)  $20,000 \times 65\% = 13,000 \times 18\% = 2,340$  TVSH e zbritshëm pasi qe sipas ligjit te TVSh duhet përdoret koeficienti i vitit paraprak.

## Problemi 2

5 pikë

Kompania KOBRA SH,P.K për vitin që përfundon me 31.12.2015 kishte një fitim para tatimit €90,000. Shpenzimet e donacionit për këtë viti ishin 10,000 EUR. Pas një rishikimi u konstatua se në shpenzimet e përfaqësimit ishin përfshirë si shpenzim mbi limitin e lejuar sipas ligjit, vlera e mbi limitit ishte 5,000 Eur

### Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë KOBRA Sh.p.k. me 31.12.2015.

### Zgjidhje

Fitimi Para Tatimit	90,000
Shpenzimet e përfaqësimit	5,000
<u>Donacioni</u>	<u>10,000</u>
Fitimi para Donacionit	105,000
<u>1* Donacioni</u>	<u>( 10,000)</u>
Fitimi para tatimit	95,000
<u>Tatimi 10%</u>	<u>9,500</u>

1\* Donacioni lejohet deri në 10% të fitimit para tatimit

### Problemi 3

10 pikë

Kompania QRBP SH,P.K për vitin që përfundon me 31.12.2015 kishte një qarkullim prej EUR 2,200,000. Shpenzimet e përgjithshme 1,100,000.

**Informacion shtesë: Te gjitha këto shpenzime si me poshtë janë përfshire në shpenzimet e përgjithshme me përjashtim të pikës 3.**

1. Shpenzimet e zyrës prej 5,000 EUR ishin të pa mbuluar me fature 500 EUR.
2. Shuma e zhvlerësimi të pajisjes ( gërmuesit të dheut) prej 10.000 eur për këtë vite është zhvlerësuar në shkallën 20% edhe pse pajisja u ble në shtator të këtij viti. Pajisja i takon grupit të dytë.
3. Nuk është aplikuar zbritja e posaçme për pasurin e re ( gërmuesin e dheut).
4. Në kuadër të shpenzimet e përfaqësimit prej 35,000 Eur ishin përfshirë edhe shpenzimet e marketingut në vlerë prej 5,000 Eur.
5. Shpenzimet e donacionit për këtë vit janë 25,000 Eur.
6. Gjobat në vlerë prej 9,700 Eur
7. Qiraja për muajin Dhjetor 2015 prej 2,500 eur sipas marrëveshjes do të paguhet në Prill 2016 po në të njëjtin muaji do të ndalet tatimi në burim.

**Kërkohet:**

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë QRBP Sh.p.k. me 31.12.2015

## Zgjidhje

Te ardhurat	2,200,000
SHP	(1,100,000)
<hr/>	
Fitimi Kontabël	1,100,000

### Rregullimet:

Sh. zyrës(1*)	500
Zhvlerësimi (2*)	5,000
Zbritja e posaçme(3*)	(5,000)
Shpenz. përfaqësimit (4*)	8,000
Donacioni	25,000
Gjoha(5*)	9,700
Qiraja(6*)	2,500
<hr/>	
Fitimi par Donacionit(7*)	<b>1,145,700</b>
Donacioni	<b>(25,000)</b>
<hr/>	
Fitimi para tatimit	<b>1,120,700</b>
Tatimi (10%)	<b><u>112,070</u></b>

1\* Sh. zyres. Te pambuluara me fature prej 500 EUR(Shpenzimet e pazbritshme)

2\* Zhvlerësimi  $10,000/2 = 5000$  (shpenzim i pazbritshem pasi qe aset është blere ne gjashtëmujorin e dyte)

3\* Zbritje e posaçme për asetin e ri lejohet 10% e vlerës kushtuese vetëm ne vitin e blerjes  
Shpenzimi i zhvlerësimit  $10,000/20\% = 50,000$  Vlera e asetit  
 $50,000 \times 10\% = 5,000$  zbritje e posaçme

4\* Shpenzimet e përfaqësimit

$35,000 - 5000$  (shpz.marketingu) = 30,000

Qarkullimi  $2,200,000 \times 1\% = 22,000$  (limiti i shpenzimeve te lejuara)

Shpenzimet e përfaqësimit  $30,000 - 22,000 = 8,000$  (shpenzime te pa lejuara)

5\* Gjoha ne tërësi sipas ligjit te TAK janë shpenzime te pa zbritshëm.

6\*Qiraja – Shpenzimet qe lidhen me tatimin ne burim( si ne rastin tone Qiraja) sipas Ligjit TAK nëse nuk paguhen deri me 31 Marse te vitit ne vijim janë shpenzime te pa zbritshëm për atë periudhë

7\* Donacioni pranohet ne tërësi si shpenzim pasi qe është nen limitin e lejuar nga Ligji TAK ( 10% e fitimit para donacionit)

#### Problemi 4

10 pikë

“TOK” SH.P.K regjistroj blerje gjatë Maj/2016 në shumën Eur 125,000 me normën standarde; blerje në shumën 60,000 EUR me normën e reduktuar; shitjet vendore në këtë muaj ishin Eur 300,000 me normën standarde dhe 30,000 EUR me normën e reduktuar (Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë TVSH-në).

Ne muajin Maj 2016 “TOK” SH.P.K ka pranuar një Note Debiti nga një furnitor për një blerje në muajin Dhjetor 2015. Vlera e TVSH-së në këtë note debiti është Eur 3,300 (me normë standarde);

Ka pranuar një Note Krediti nga një furnitor për blerjet në muajin Shkurt 2016. Vlera e TVSH-se në këtë note krediti është Eur 500 (me normë të reduktuar);

Ka pranuar një faturë shërbimi nga kompania konsulente IMTECH me seli në Gjermani në vlerë prej 20,000 EUR

“TOK” SH.P.K po në këtë muaj (Maj 2016) lëshojë një Note Krediti në të cilën vlera e TVSH-se është Eur 3,100 (me normë të reduktuar)

#### Kërkohe:

A ka detyrim TVSH-së për të paguar në këtë muaj “TOK” SH.P.K”, nëse po, sa është obligimi? Plotëso deklaratën tatimore.

#### Zgjidhje

##### Libri i shitjeve

Shitjet me norme të reduktuar	$30,000 \times 8\% = 2,400$
Shitjet me norme standarde	$300,000 \times 18\% = 54,000$
Note Krediti (e pranuar)	$6,250 \times 8\% = 500$
<u>Ngarkesa e Kundërt</u>	<u><math>20,000 \times 18\% = 3,600</math></u>
TOTAL TVSH e llogaritur	60,500

##### Libri i blerjeve

Blerjet me normën e reduktuar	$60,000 \times 8\% = 4,800$
Blerjet me normën standarde	$125,000 \times 18\% = 22,500$
Note Debiti (i pranuar)	$18,333 \times 18\% = 3,300$
Note Krediti (i lëshuar)	$38,750 \times 8\% = 3,100$
<u>Ngarkesa e kundërt</u>	<u><math>20,000 \times 18\% = 3,600</math></u>
TOTAL TVSH e zbritshëm	37,300

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshme

TVSH e pagueshme = 65,500 - 37,300 = 23,200

## Problemi 5

10 pikë

Omega sh.p.k. ka deklaruar dhe paguar me dy muaj vonesë sipas kohës së paraparë me ligj për periudhën tatimore 05/2015 për TVSH shumë prej 20,000 Eur. Në muajin Maj 2016 ka pranuar aktin final të kontrollit për periudhën 05/2015 për TVSH. Në aktin final ATK ka konstatuar tatim shtesë prej 8,000 EUR.

### Kërkohe:

Sa janë gjodat dhe interesi PËR TATIMIN SHITESË (sipas aktvendimit të ATK-së) që kompania duhet paguar duke u bazuar në kalkulimet që parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore ?

### Zgjidhje

1* Gjoda për nen deklarim tatimor	$8,000 \times 25\%$	= 2,000
2* Gjoda për mos deklarim në kohe	$8,000 \times 10\%$	= 800
3* Gjode për mos pagese në kohe	$8,000 \times 10\%$	= 800
4* <u>Interesi</u>	$8,000 \times 8.4\%$	= 672
<b>TOTALI</b>		<b>4,272</b>

1\* Neni 52 pika 1.2 i ligjit për procedurat ATK-se- nëse nen deklarimi është me i lartë se 10 % ndëshkimi është 25% i shumës së nen deklaruar.

2\* Neni 51 pika 1 i ligjit Proc. ATK për mos deklarim të tatimit në kohe ndëshkim 5% për muaj max 5 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 2 muaj vonesë.

3\* Neni 51 pika 2 i ligjit Proc. ATK për mos pagese tatimit në kohe ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 10 muaj.

4\* Neni 28 pika 1 i ligjit Proc. ATK-së, deri në ditë e pagese të tatimit llogaritet interes 0.70% në muaj. Në rastin konkret në kemi të bëjmë me 12 muaj mos pagese të tatimit.



## Problemi 6

5 pike

Asdreni gjate viti 2015 u punësua si i rregullt tek kompania “Ylli” Sh.P.K.. Realizoj te ardhura bruto 4,800 Eur. Për këto të ardhura kompania i ndali tatim në burim prej 206.40 Eur. Ndërsa tek kompania TOK u punësuar si puntor sekondar ku realizojë të ardhura bruto prej 2,400 Eur dhe që ju ndal tatim në burim nga kompania prej 228 Eur .

### Kërkohet:

- Plotësoni deklaratën përfundimtare të Asdrenit për vitin 2015
- Sa është shuma e tatimit që Asdreni do të rimbursion për këtë vit.

### Zgjidhje

a)

Të ardhurat primare	4,800
<u>Të ardhurat sekondare</u>	<u>2,400</u>
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>7,200</b>

$$KP-7,200 \times 5\% = 360$$

$$KP = 360 + 360 = 720$$

### TAP

$$\text{Te ardhura e tatueshme } 7,200 - 360 = 6,840$$

$$0 - 960 = 0$$

$$960 - 3,000 = 4\% - 2,040 \times 4\% = 81.60$$

$$3,000 - 5400 = 8\% - 2400 \times 8\% = 192.00$$

$$\underline{5,400 - 6,840 = 10\% - 1,440 \times 10\% = 144.00}$$

$$\text{Total TAP} = 417.60$$

b)

$$\text{Obligimi per TAP} \quad 417.60$$

$$\underline{\text{Tatimi i ndalur ne burim} = 206.40 + 228.00 = (434.40)}$$

$$\text{Rimbursim} \quad -16.80$$

## Problemi 7

10 pike

Kompania Ëndrra SH. A me datë 01.01.2015 kishte këtë gjendje te aseteve sipas kontabilitetit:

Grupi I - Dy ndërtesa me vlere 230 000 eur respektivisht 180,000 eur

Grupi II - 120,000 eur

Grupi III - 1,200,000

Grupi (1000-3000) -12,200

### a) Gjate 2015 kompania beri këto investime ne asete:

Me datë 01.09.2015 bleu një Kamion të rendë të ri në Gjermani, kostoja e të cilit ishte 48,000 Eur pas të gjitha taksave dhe shpenzimeve deri ne selinë e kompanisë.

### b) Gjate vitit 2015 kompania shiti këto asete:

Me date 04.05.2015 kompania shiti kamionin e blerë në vitin e kaluar pasi që nuk ishte i kënaqur me kualitetin e tij, vlere e shitjes ishte 35 000 Eur,(vlere kushtuese e kamionit ishte 50,000 Eur dhe zhvlerësim te grumbulluar nga viti i parë ishte 10,000 Eur).

Në Qershor të vitit 2015 shiti dy kompjuter për 2000Eur të blerë po në vitin e kaluar që i takojnë grupit( 1000-3000),(vlere kushtuese e dy kompjuterëve ishte 2,800 Eur dhe zhvlerësimi i akumuluar 560 Eur).

Kërkohet:

Llogariten zhvlerësimin dhe çfarëdo shpenzimi qe lidhet me asetet për vitin 2015 ?

Kalkuloni humbjen apo fitimin ne shitjet e aseteve nëse kërkohet me ligj?

## Zgjidhje

a) ZHVLERSIMI

2015

### Grupi I

Nder. I  $230\,000 \times 5\% = 11,500$

Nder. II  $180\,000 \times 5\% = 9,000$

**TOTAL 20,500**

### Grupi II

a) Asetet e bartura  $120\,000 - 50,000 = 70,000 \times 20\% = 14\,000$

1\* Kamioni  $48\,000 \times 20\% / 2 = 4,800$

**TOTAL 18,800**

1\*sipas ligjit asetit qe blihet ne gjysmën e dyte te vitit zhvlerësohet vetëm 50% e shkalles se lejuar.

b) Zbritja e posaçme për kamionin e ri

$48,000 \times 10\% = 4,800$  Eur ( shpenzim i periudhës)

### Grupi III

Asetet e bartura  $1\,200\,000 \times 10\% = 120\,000$

### Grupi i veçanta (1000-3000)

Asetet e bartura  $12,200 \times 20\% = 2,240$

## b) SHITJA e ASETETEVE

1. Kamioni

Kostoja	50,000
Zhvlerësimi e akumuluar	(10,000)
Vlera Neto	40,000
Vlera e shitjes	(35,000)
Humbja	5,000

2. Asetet e grupit te veçanta (kompjuterët)

E ter vlera kushtuese se dy kompjuterëve te këtij grupi konsiderohet si e ardhur dhe grupi nuk zvogëlohet sipas ligjit TAK, pra 2,800 Eur te ardhura nga shitja e asetit .